- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>3</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

<sup>3</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 8/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

a) **Operatori ekonomik duhet te vertetoje qe ne aktivitetin e tij tregtar, (QKR), ka ne objekt mallrat qe do te prokurohen.**

#### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Kopje te vertetuar te bilanceve, te konfirmuara me vule prane autoriteteve perkate se (Administrates Tatimore ) te tre viteve te fundit te aktivitetit (2017, 2018, 2019).

Te gjitha subjektet qe i nenshtrohen përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, duhet te paraqesin bilancet e te tre viteve te fundit te aktivitetit (2016, 2017, 2018), te audituara nga ekspertet kontabel te licensuar,

b. Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore, ku xhiroja mesatere e tre viteve te fundit të mos jete me vlerë më të ulët se 40% e fondit limit që prokurohet.

Kerkesa e bilanceve, xhiros dhe te jete konform nenit 46/c te LPP, ku parashikohet se: gjendja ekonomike e financiare: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesë vetë shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur, si dhe ne respektim te nenit 27/5/a/b te Vendimit te Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë*



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar, ku parashikohet se:  
“Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiar edhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose
- b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerëslimit të kontratës që prokurohet”;
- c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marre jo me pare se 30 dite nga data e hapjes se ofertave.**

Kjo kerkese vjen ne respektim te nenit 27/5/c te Vendimit te Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne te cilin parashikohet:“Për të provuar përmbushjen e Kriterit për Kapacitetet Financiare dhe Ekonomike, Autoriteti Kontraktor kërkon: Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, për veç rastiit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizues i i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

d)Vërtetim qe konfirmon shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019 dhe 2020 leshuar nga Bashki/te ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas QKB-se.

Kjo kerkese eshte hartuar ne baze te ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

#### 3.1 (Përvoja te mëparshme)

- a) Furnizime të ngjashme për një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit, që janë realizuar gjatë tre viteve te fundit.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë:

Ne rast se furnizimet janë kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ENT publik për realizimin e kontratës, fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

Ne rast se furnizimet janë kryer me sektorin privat:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

Kriteri mbi përvojën e mëparshme është bërë sipas parashikimeve të nenit 27/4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, indryshuar, indryshuar, ku parashikohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara”.*

### **3.2 Ofertuesi duhet të paraqesë:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë broshurat/kataloget/manualët zyrtarë të kompanive prodhuese për të gjithë produktet objekt prokurimi që ofron ku të vërtetohet plotësimi i të gjithë specifikimeve teknike të kerkuara.
3. Operatori ekonomike ofertues duhet të paraqesë për Rele mbrojtje+kontrolli certifikatat që produkti është konform standardeve EN 60255-26:2013, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 për protokollat PPR dhe HSR, IEC 61850-6,7-1,7-2,7-3,7-4,8-1 Niveli A, Standardet e IEEE-se C37.238TM-2017 dhe DNP 3.0.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

4. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese per Rele mbrojtje+kontrolli test-raportet qe produkti eshte konform standardeve EMC dhe LVD. Direktiva EMC 2014/30/EU, Direktiva per tensionin e ulet 2014/35/EU, EN 60255-26:2013, CISPR 11:2015, CISPR 22:2008, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 dhe IEEE 802.1D per protokollet PPR dhe HSR, IEC 61850-4,6,7-1,7-2,7-3,7-4,8-1,10, Standardet e IEEE-se C37.238TM-2017 dhe DNP 3.0.
5. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese per Panelin e mbrojtjes certifikatat dhe test-raportet qe vertetojne produkti eshte konform standardeve EN 61439-2:2011, EN 61000-6-2:2005, EN61000-6-4:2007+A1:2011 si dhe test raportin qe paneli eshte IP42 ose me mire.
6. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese per Bllok Testin certifikatat dhe test-raportet qe vertetojne se produkti eshte konform standardeve EN 60947-7-1:2009.
7. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese per Matesin e parametrave te energjise certifikatat qe vertetojne se produkti eshte konform standardeve EN 61000-6-3:2007, EN 61000-6-1:2007, EN 61000-3-2:2006 dhe EN 61000-3-3:2005.
8. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese per Switch-in certifikatat dhe test-raportet qe vertetojne se produkti eshte konform standardeve EN 60255-26:2013, EN 55032:2012, EN 61000-3-2:2014, EN 61000-3-3:2013, EN 55024:2010, EN 60950-1 dhe IEC 61850-3.
9. Operatori ekonomike ofertues duhet te paraqese certifikatat e cilesise ISO te prodhuesit dhe CE te kabujve qe ofron.
10. Operatori ekonomik ofertues, ne momentin e hapjes te ofertave, duhet te paraqese moster te panelit te mbrojtjes se kerkuar. Paneli duhet te jete i ri, i paperdorur, te jete i kompletuar me te gjitha paisjet perberese te kerkuara dhe te jete gati per t'u vendosur ne pune dhe per t'u testuar nga AK. Dorezimi i mostrave do te behet ditën e hapjes se ofertave ekonomike.

Mostrat do te qendrojne ne magazinën DTL per te garantuar saktesine e mallit te ofertuar. Mosparaqitja e mostrave eshte kusht per skualifikim.

Kerkesat e sipercituara jane hartuar ne baze te nenit 27/6 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për rivlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt I shqyrtimit administrative apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit për fundimtar të anulimit; dhe/ose*

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

*b) dëshminë e originalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.*

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese nje deklarate qe mallrat e furnizuara jane te reja (dhe jo te perdorura).
12. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me çertifikatë ISO 9001:2015 (Ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe shëndetit me çertifikatë OHSAS 45001:2007 (Ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të ambientit me çertifikatë ISO 14001:2015 (Ose ekuivalent) dhe certifikaten ISO 50001:2011 (Perditesuar) per miremenaxhimin e energjise për instalimin e paneleve te mbrojtjes ne objektet perkatese.
13. Operatori ekonomike ofertues duhet të kete pjese te stafit te pakten nje punonjes i cili te jete i trajnuar nga kompania/te prodhuese e mallrave objekt prokurimi, per trajnimin e stafit te Autoritetit Kontraktor per perdorimin dhe konfigurimin e pajisjeve. Kjo te vertetohet me ane te certifikatave te leshuara nga kompania prodhuese e produkteve te ofruara.
14. Ofertuesi duhet të paraqese dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Ne kete table duhet te paraqiten te dhenat e sakta per te gjithe produktet . Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi I mallit	Specifiki met teknike te kerkuara	Specifikime t teknike te mallit te ofruar	Emri i kompanise prodhuese	Emertimi i katalogut Referenca ( kodi i produktit)	Shenime sqarues e
1	F.V Paneli i mbrojtjes (struktura metalike)					
2	Rele mbrojtje					
3	Blok test					
4	Matesi i parametrave te panelit					
5	Switch					
6	Sinjalizuesi i alarmeve					
7	Kabujt per panelet					

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

Plotesimi i gabuar ose mos plotesimi i ofertes teknike per nje ose disa produkte perben kusht per skualifikim.

15. Operatorët ekonomike të interesuar, brenda 10 ditëve pas shpalljes së procedurës së prokurimit në sistemin e APP-së duhet të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor që të organizohet një Site-Visit në të gjithë ambientet ku do të montohen panelet.
16. *OE duhet te paraqese nje deklarate qe merr persiper furnizimin dhe vendosjen e mallrave objekt prokurimi sipas kerkesave te AK.*
17. Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qera 1 (nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës nga 5 ton -10 ton.

Per te vertetuar keto mjete duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore, Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit lëshuar nga njësia vendore përkatëse. Për mjetet me qera duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore, , Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit lëshuar nga njësia vendore përkatëse.*
- b) *Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- c) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- d) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- f) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*

*Ne te gjithë rastet e permendjes se ndonje marke, skice, standarti ose certifikate si ne specifikimet teknike edhe ne kriteret per kualifikim, pranohen edhe ekuivalentet e tyre.*

18. OE duhet të paraqesë nje deklarate qe ne rast se shpallet fitues i kesaj procedure duhet te paraqese projektet e vendosjes dhe montimit të paneleve te cilat të ketë marrë miratimin paraprak nga stafi teknik i AK-së që këto projekte janë sipas rregullave dhe standarteve që

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

zbaton OSSH-ja. Pas miratimit të këtyre projekteve, OE I shpallur fitues mund të vazhdojë me montimin e paneleve në nënstacionet përkatëse sipas kërkesave të AK-se.

**Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre dhe në gjuhën shqipe. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shënim: Në respektim të nenit 23 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke ose Standart” përfshihet termi “ekuivalente”.**

*(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

**Shënim (për pjesën e kontratës) :**

Gjithashtu me levrimin e mallit, furnizuesi i mundshëm duhet të paraqesë për materialet :

- a. Autorizim prodhuesi.*
- b. Certificate ISO 9001;2015 e prodhuesit.*
- c. Certificate Origjine.*
- d. Test raportet.*
- e. Certificate Garancie, minimum 24 (njëzet e katër) muaj nga levrimi i mallit.*

***Afati i levrimit të mallit: 6 (gjashtë) muaj total nga data e nënshkrimit të kontratës.***

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Sipas dokumentacionit bashkëlidhur.**

Specifikimi i Materialeve: **Sipas dokumentacionit bashkëlidhur.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Shtojca11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____



**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

**Shtojca 12**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet: **“Ndërtim, rikonstruksion i sistemit mbrojtës në N/Stacione kritike ku injektojnë energji HPP (Zona Korçë, Bulqizë, Librazhd etj)”**.

Afatet e lëvrimit:

***Afati i lëvrimit të mallit: 6 - (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.***

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor ]

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 16**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
Mallrat – Tender i Hapur**

**Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.



## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimit e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
